



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ANEKSIN VI TË KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE DETARE “PËR PARANDALIMIN E NDOTJEVE NGA ANIJET,
1973”, TË NDRYSHUAR ME PROTOKOLLIN E VITIT 1978 (MARPOL 73/78)”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin z. Artan Shkreli, zëvendësministër për Infrastrukturën dhe Energjinë, z. Bledar Karoli, përgjegjës sektori në MIE dhe z. Elson Thana, specialist në MIE.

Relatore për këtë projektligj ishte deputetja znj. Eglantina Gjermani.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Aderimi në këtë konventë bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Shqipërisë në Aneksin VI të Konventës Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973, të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (Marpol 73/78).

Më 27 korrik 2006, Republika e Shqipërisë ka aderuar në konventën ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973” të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (Marpol 73/78), e cila në atë kohë përbëhej nga pesë anekse.

Pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë konventë, Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) miratoi edhe aneksin VI, i cili parashikon rregulla për mbrojtjen e ajrit nga emetimi i gazeve nga djegia e karburanteve nga anijet.

Aneksi VI ka si qëllim kufizimin e ndotësve kryesorë të ajrit të përfshirë në gazrat e shkarkimit të anijeve, duke përfshirë oksidet e squfurit dhe oksidet e azotit, dhe ndalon emetimet e qëllimshme të substancave që shkatërrojnë ozonin. Aneksi VI gjithashtu rregullon djegien e karburanteve nga anijet dhe emetimet e komponentëve organikë të paqëndrueshëm nga cisternat.

Aderimi i Shqipërisë në këtë Konventë ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese, si dhe të sigurojë standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare lidhur me kërkesat për sigurinë e parandalimit të ndotjes së ajrit nga anijet.

Aneksi VI parashikon rishikime në rregulloret për substancat që shkatërrojnë ozonin, përbërjet organike të paqëndrueshme, djegien e dërgesave të anijeve, objektet e pritjes dhe cilësinë e karburantit si dhe rishikime në rregulloret për disponueshmërinë e naftës së karburantit.

Masat e rishikuara pritet të kenë një ndikim domethënës të dobishëm në mjedisin atmosferik dhe shëndetin e njeriut, veçanërisht për ata njerëz që jetojnë në qytetet portuale dhe komunitetet bregdetare.

Konkretisht Konventa vendos detyrimin që anijet e shteteve anëtare të aneksit VI të mbajnë certifikatat me anën e të cilave garantojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e ajrit. Në rastet kur anijet prekin porte detare të një shteti tjetër anëtar të aneksit VI, administrata detare e këtij porti do të inspektojë mbajtjen e këtyre certifikatave edhe nga anijet që mbajnë flamurin e një shteti jo anëtar. Mosekzistenca e këtyre certifikatave në bordin e anijes do të sjellë si pasojë moslejimin e lundrimit të anijeve, si dhe do t'i detyrojë pronarët e anijeve që të mirëmbajnë anijet, duke i plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme teknike sipas kërkesave të kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare dhe Bashkimi Evropian.

➤ EFEKTET FINANCIARE

Ky projektligj nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

➤ DISKUTIME NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit zëvendësministri z. Shkreli sqaroi se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje kërkohet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, të ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë. Gjithashtu aderimi në këtë konventë pritet të rrisë sigurinë në parandalimin e ndotjes së ajrit.

Relatorja, deputetja Gjermani ftoi deputetët e komisionit për ta miratuar këtë projektligj, duke theksuar se aderimi i Shqipërisë në aneksin VI të kësaj konvente ndikon direkt në përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve shqiptarë, sidomos atyre që jetojnë në bregdet. Deputetët e tjerë, anëtarë të komisionit e mbështetën nismën dhe Komisioni e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm.

➤ PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE
EGLANTINA GJERMEI

KRYETARE
MIMI KODHELI